



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

**V E N D I M**

Nr. 787 , datë 18.12.2024

**P Ë R**

**MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE**  
**TË DREJTËSISË 2024 - 2030, TË PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT**  
**DHE TË PASAPORTËS SË TREGUESVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024 - 2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Vendimi nr.823, datë 24.12.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021 - 2025 dhe të planit të saj të veprimit”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, institucionet e drejtësisë, ministritë e linjës dhe institucionet e tjera përgjegjëse të përcaktuara në strategjinë, në planin e veprimit, si dhe në pasaportën e treguesve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**BELINDA BALLUKU**

**MINISTRI I DREJTËSISË**

**ULSI MANJA**